



Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe (km2)	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
1.	Berat	1-Shpirag	19183	381.8	15	Velabisht	11964	93	Malinat, Bilce, Drobonik. Bardhaj i Ri, Starove, Velabisht, Veterrik, Remanice, Gjoroven, Palikesht, Veleshnje, Duhanas, Kodras
						Sinje	5167	146.3	Sinje, Mbolan, Mbjeshove, Mbreshtan, Galine. Sadovice, Paftal, Kamçisht, Levan, Velçan, Osmenzeze 1, Osmenzeze 2, Plashnik i Vogel, Molisht
		Terpan (Poliçan)				2052	142.5	Terpan, Teman, Paraspuar, Tozhar, Vokopole, Dodovec, Rehove, Zhapokike, Corogjaf, Panarit, Plashnik i Madh, Lugas, Zhitom i Madh, Zhitom I Vogel	

Shënim:

1-Shpiragu është formuar nga 2 NJA që i përkasin bashkisë Berat dhe NJA Terpan, që sot i përket Bashkisë Poliçan. Terpani ka kërkuar vetë të mos jetë administrativisht me Poliçanin. I përket dhe historikisht zonës së Beratit, dhe afërsi për shërbime dhe infrastruktura i akomodon nga kjo bashki.

2-Qendra e bashkisë është propozuar Velabishta për arsye se është qendra që i lidh më mirë të 3 njësitë, është më urbane si zonë, ka më shumë popullësi, ka më shumë kapacitete akomoduese për administratën e re të bashkisë etj.

3- Emri Shpirag: e ka marrë nga emri me të cilën njihet e tërë krahina dhe mali Shpirag.

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe (km2)	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
1.	Berat	2-Otllak 	21374	200.5km ²	15	Otllaku	9218	63.2 km ²	Fshatrat; Lapardha 1, Lapardha 2, Qereshnik, Balibardhë, Dyshnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e Sipërme, Orizaj, Otllak
						Roshnik	2513	81.8 km ²	Fshatrat; Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimias, Perisnak, Qafë Dardhë, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogel, Vojnik, Rabjak
						Lumas	9643	55.5 km ²	Fshatrat; Lumas, Luzaj, Pëllumbas, Katundas, Zelevizhdë, Belesovë, Mëndrak, Sheqës, Bardhaj, Pashtraj, Vodëz, Krekëz, Koritëz

Shënim:

1- Bashkia Otllak ishte nje njesi vendore e perbere nga njesite administrative Otllak dhe Roshnik qe sot jan me Beratin dhe NJA Lumas qe eshte pjese e bashkise Kucove. Ne total popullsia shkon rreth 25000 banor .

2-Qendra e bashkise Otllaku. Kane lidhje te logjikshme gjeografike , por edhe me lidhje te forta te tradites dhe familjeve te ndryshme .

Ka ne teritorin e saj biznese dhe veprimtari te ndryshme ekonomike , qe do te ishin te mjaftueshme nga ana financiare per vetadministrimin e kesaj bashkie .

3- Emri Otllak .

Nr	Qarku		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrati ve perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Njesi te qeverisjes vendore	Bashkia							
2	Diber	3-Maqellarë	14425	87.2	15	Maqellarë	14425	87.2 km2	Maqellare, Bllate e Poshtne, Bllate e Sipenne. Burim, Cernen, Fushe e Vogel, Katund i Vogel, Kercisht i Siperme, Kercisht i Poshtem, Kllobçisht, Kovashice, Majtare, Pocest, Pesjak, Podgorc, Vojnik, Dovolan, Erebare, Grezhdan, Herbel, Popinar, Gradec




Shënim:

1-Bashkia Maqellarë është formuar nga 1 NJA: Maqellara. Kanë një histori dhe konektivitet të mirë me njëra tjetrën. Baza ekonomike është sektori bujqësor, tregëtia, bizneset e llojeve të ndryshme, linja prodhime e pemtari etj. Kjo bashki krijon një nyje administrative dhe ekonomike ndërmjet Dibrës dhe Bulqizës.

2- Qendra e bashkisë është propozuar Maqellara për arsye se ka popullësi më të madhe, është më urbane, ka më shumë akseset akomoduese për një bashki të re për tu bërë qendër e stabilizuar administrative. Ish-komuna rikthehet bashki.

3- Emri është menduar Maqellarë si emër identifikues dhe historik i krahinës që nga viti 1467 si një nga vilajetet e Dibrës së poshtme. Ka dhe një propozim tjetër për ti vendosur emrin Arbër. (nga Principata Arberit) ose si porta hyrëse e rrugës së arbërit për në Diber.

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrati ve perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre	
	Qarku	Bashkia								
	Dibër	4-Kastriot	15693	235.4 km2	15	Kastriot	7406	63.4 km2	Kastriot, Brest i Sipërm, Brest i Poshtem, Kishavec, Kander, Kukaj, Vakuf, Fushe-Kastriot, Borovjan, Deshat, Limjan, Sohodoll, Sohodoll i Vogël, Vrenjt, Pergjegje.	
						Fushe-Cidhen	3379	15 km2	Fushe Cidhen, Bllice, Lace, Rrenz	
							Sillove	2713	78 km2	Sillove, Kalle, Vleshe, Zall-Kalis, Dypjake, Palaman, Sllatine, Shumbat, Venisht, Trojak
							Kala e Dodes	2195	79 km2	Ceren, Kullas, Ploshtan. Radomire, Shullan, Tejze, Ujemire, Vasje

Shënim:

1-Bashkia Kastriot krijohet nga bashkimi i 4 NJA si: Kastriot, Fushë-Cidhen, Sillovë dhe Kala e Dodes. Bashkia e re përfaqëson interesa të përbashkëta për komunitetet respektive. Është një bashki me dominancë kodrinore dhe malore sa i përket relievit. Baza ekonomike përbëhet nga zhvillimi rural, blektoria, turizimi malor, etj.

2-Qendra e Bashkisë Kastriot, për arsye se është një qendër më urbane, përbën një nyje të mirë administrative dhe akomodon interesa administrative dhe me prespektivë të mire si mikrorajon në atë zonë.


3-Emri: Natyrshëm e ka Kastriot nga Heroi Kombëtar.

Nr	Njësi të qeverisjes vendore		Popullsia	Sipërfaqe	Nr. i Këshilltarëve	Njësitë administrative përbërëse	Popullsia	Sipërfaqe	Fshatrat në përbërje të tyre
	Qarku	Bashkia							
	Dibër		6077	281.4 km ²	15	Lure	1095	125.5 km ²	Arth, Fushe-Lure, Borie-Lure, Gur-Lure, Lure e vjeter, Aremolle, Krej-Lure, Pregj-Lure, Sumej, Vlashej.
						Arras	3250	70 km ²	Arras, Gur i Zi, Lazrej, Koder Leshaj, Mustafa, Sine e Poshtme, Sine e Siperme, Cidhen, Gryke Noke.
						Zall Dardhe	1051	39.6 km ²	Zall-Dardhe, Lashkize, Lugjej, Menesh, Nezhaj, Qa, Sorice, Shenlleshen, Tartaj
						Rec	681	46.3 km ²	Zall-Rec, Bardhaj-Rec, Draj-Rec, Gur-Rec, Hurdhe-Rec, Kraj-Rec, Ndershene, Qafdraj, Tharke

Shënim:

- 1- Bashkia Lurë: është nga bashkitë që bën bashkë 4 NJA: Lurë, Arras, Zall Dardhë dhe Reç. Një bashki me numër të madh NJA dhe sipërfaqe. Baza e zhvillimit ekonomik është bujqësi, pemtari, blegtori, livadhe pyje e kullota malore. Burimet ujore të Lurës përbëjnë thesarin e kësaj bashkie, thesar që i shkëlqen turizmi si burim dhe vlerë në këto zona.
- 2- Qendra e Bashkisë - Lurë. Kjo ndryshe nga disa raste të tjera që lidheshin me popullsinë dhe element të tjerë, vendosja e administratës në Lurë, krijon një njësi administrative dhe një pol ekonomik me bazë të fortë turistike për atë që ofron vetë Lura dhe kapitali i saj natyror, dhe parku kombëtar i saj na orientojnë këtu.
- 3- Emri Lurë: mendojmë se është përbashkues dhe përfaqësues i krahinës. Ky emër është shfaqur në defterët Otoman të vitit 1467.

Nr	Qarku		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrati ve perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Njesi te qeverisjes vendore	Bashkia							
2	Diber	6-Shupenzë	10777	183.2 km2	15	Gjoricë (Bulqize)	5476	35 km2	Gjorice e sipërme, Gjorice e poshtme, Cerenec I sipërm, Cerenec I poshtëm, Vicisht, Lubalesh
						Ostren (Bulqize)	4308	98.7 km2	Ostren I madh, Ostren I vogël, Radovesh, Lejcan, Orzhanove, Terbac, Oreshnje, Okshtun I vogël, Pasinke, Lladomerice, Tucep, Okshtun I madh dhe Kojavec.
						Trebisht	993	49.5 km2	Klenje, Gjinovec, Trebisht-Balaj, Trebisht-Celebi, Trebisht- Mucine, Vernice.




Shënim:

1-Shupenza krijohet nga bashkimi me 3 NJA që sot i perkasin bashkise Bulqize, përkatesishtë: Gjorice-Ostren-Trebishte.

Eshte nje njesi qe shtrihen ne nje territory malore. BAza ekonomike eshte bujqesia dhe blegtoaria, bimet eromatike dhe medicinale.

2-Qendra Shupenze-pasi ofrim nje potencial te pranueshem per aktivitetet administrative, sociale dhe aksesohet mire me qendrate e tjara admsitrative si Maqellare, Diber dhe Bulqize.Prazanton nje nivle urabnizimi me te mire krahasuar me NJA tj.

3- Emri- Shupenze- eshte me perfaqesues dhe identifikues I zonese per vete historin e saj qe daton qe nga viti 1272 (me fshatin Gryke e Vogel) prone e fisnikut Arber Sevast Pal Gropa.

Nr	Njësi të qeverisjes vendore		Popullësia	Sipërfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njësitë administrative përbërëse	Popullësia	Sipërfaqe	Fshatrat në përbërje të tyre
	Qarku	Bashkia							
3	Durrës	 1:150,000	52621	161.75 km ²	31	Sukth (Durrës)	30629	53 km ²	Sukth, Hamallaj, Kulle, Perlat, Vadardhe, Rrushkull, Hidrovori
						Manez (Durrës)	12593	43.25 km ²	Qyteti Manez, Armath, Borc, Hamallaj, Kameronas, Rade, Shkalle, Fshat Manez
						Ishëm (durrës)	9399	-65.5 km ²	Likmetaj, Kertushaj, Kapidanaj, Gjericaj, Lalez, Kuraten, Bize, Drac, Shetaj, Rrotull.

Shenim:

-Bashkia Sukth, krijohet nga bashkimi i tre NJA nga Durrësi (Sukth, bashki deri ne 2015 dhe Ishëm, Manëz). Në listën e bashkive të reja që krijohen nga ky riorganizim, Ishmi është bashkia më e madhe në popullsi. Baza e zhvillimit ekonomike të kësaj bashkie është bujqësia, shërbimet, tregtia, turizmi dhe prespektiva për urbanizim. Vija bregdetare e Ishmit është zemra e turizmit por jo vetëm për këtë bashki.

-Qendra e Bashkisë: Bashkia Sukth propozohet të ketë qendrën administrative në Sukth. Kjo për arsye se është në një zonë të mirë aksesueshme nga të gjithë NJA. Ka një urbanizim dhe qendër me prespektive urbane të trashëguar por edhe potenciale për njerë.

-Emri: Sukth.

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Durrës	8-Fushë-Krujë	46268	176.0 km2	21	Fushë Krujë	27868	74,5 km2	Qyteti Fushë Krujë, Fshatrat; Fushë Krujë, Arrameras 1, Luz 1, Hasan, Larushk 1, Halil, Zgërdhesh, Zallë, Luze 2, Larushke 2, Arrameras 2
						Bubq	8985	52.2 km2	Bubq, Bilaj, Budull, Mazhe-Madhe, Mazhe-Vogel, Mallkuc, Murqine.
						Nikël	11396	49.3 km2	Nikel, Tapize, Qereke, Rinas, Virjon, Buran, Mukaj, Kurcaj, Zeze



Shënim:

-Bashkia Fushe Kruje: krijohet nga bashkimi i 3 NJA: Fushe Kruje qe deri ne 2015 ka qene bashki, dhe dy NJA (ish komuna) Bubq dhe Nikel. Bashki me nje popullsi afro 50.000 banore dhe nje dinamike zhvillimi te konsiderushme. Baza e Zhvillimit ekonomik ne kete bashki nje nje kompleks sherbimesh, mallrash, nga bizneset e vogla te ato te medha, nga bujqesia te sektore te tjere ndertimi, prodhimi dhe sherbime etj.

-Qendra e bashkise: kjo bashki do kete qender administrative aty ku ka qene dikur kur ishte bashki me vete, pra ne Fushe Kruje.

-Emri: Fushe Kruje eshte emri tradicional i kesaj zone nen Kruje dhe meqe ka qene dikur bashki me kete emer serisht memoria e komunitetit e mban te tille dhe si bashki qe rikthehet.

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
4	Elbasan	9-Shpat	37037	429km2	21	Shushicë	11765	88.3 km2	Shushice, Shelcan, Mlize, Hajdaran, Fush-Bull, Vasjan, Polis I vogel, Polis Vale, Vreshtaj.
						Gjinar	3478	132.7 km2	Gjinar, Leshan, Valesh, Pashtresh, Derstile, Lukan, Sterstan, Xibresh, Maskarth, Kaferr, Pobrat
						Zavalinë	1622	95 km2	Zavaline, Selte, Karnican, Joronishte, Nezhan, Burrishte.
						Tregan	4622	64.4 km2	Tregan, Blerimas, Bizhdan, Cikallesh, Gurisht, Kacivel, Kycyk, Mucan, Shinavlash, Shilbater, Trepsenisht, Tudan
						Gjergjan	8243	27.3 km2	Gjergjan, Bujaras, Gjonme, Keshtjelle, Koder Bujaras, Muriqan, Thane.
						Shirgjan	7307	21.3	Shirgjan, Bathes, Bujqes, Jagodine, Kuqan.




Shenim:

-Bashkia Shpat: edhe kjo bashki eshte nder bashkite qe eshte krijuar nga bashkimi i 6 NJA. Nje bashki me potencial te madh ekonomik ne agroturizem dhe turizem rural e malor (Gjinari dhe Bysheku) qe perbejne edhe simbolin e turizmit ne kete bashki. Po edhe sherbime dhe prodhime nga sektoret e tjere jane ne prespektive si rezultat i presionit per shfryrje urbane nga qendra e qytetit Elbasan.

-Qendra e Bashkise: Propozohet Shushica si opsioni primar, por edhe Shirgjani ka potencial per te qene qender e administrates se bashksie Shpat. Eshte menduar dhe propozuar Shushica ne kete rast si qender banimi me popullesi me te madhe se te tjerat, me e aksesueshme, me infrastrukture akomoduese administrative me te mundshme. Eshte nje nyje ekonomike dhe turistike qe ben simbioze mes Elbasanit dhe Krahines se Shpatit.

Emri: Shushicë bashkon traditat dhe krahinen e Shpatit me te gjithë fshatrat dhe NJA

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							


						perberese			
Elbasan	10-Bradashesh		37914	471.6 km2	21	Papër	9485	77.5 km2	Paper, Broshke, Murras, Valas, Vidhas, Pajun, Bizhute, Paper-Sallak, Vidhas-Hasgjel, Lugaj, Jatesh, Balldre, Ullishtaj.
						Bradashesh	10700	55.2 km2	Bradashesh, Balez-Lart, Balez Poshte, Kusarth, Kozan, Karakullak, Letan, Rrile, Shtemaj, Ulen, Katund i ri, Fikas, Petresh, Shemhill, Shijon, Recan, Gurabardh.
						Gracen	2192	79.5 km2	Gracen, Plangarice, Terbac, Bodin, Shingjin, Gjorm, Pajenge, Marnel, Dopaj.
						Funar	2751	73.7 km2	Branesh, Bixelle, Prec e Siperme, Ceruje, Korre, Mollagjesh, Krrabe e Vogel, Prec e Poshtme, Stafaj.
						Labinot Mal	5655	125.7 km2	Labinot Mal, Gur i zi, Serice, Lamolle, Bene, Lugaxhi, Qafe, Qerret, Shmil, Dritas
						Labinot Fushe	7131	60 km2	Labinot Fushe, Godolesh, Griqan i siperme, Griqan i Poshtem, Xibrake, Mengel.

Shenim:

-Bashkia Paper krijohet nga 6 NJA: Paper, Bradashesh, Gracen, Funar, Labinot Fushe dhe Labinot Mal. Sipefaqe e konsiderueshme dhe popullesi mesatare me bashkite sot. Kjo bashki ka 2 NJA me potencial te mire ekonomik sic jane Bradasheshi dhe Paperi, por ka dhe 2 NjA shume te varfera dhe malore sic jane Funara dhe Gracen. Mesatarisht me zhvillim ekonomik rural 2 NJA tjera te Labinotit. Baza ekonomike edhe ketu eshte sektori bujqesor, prodhime dhe sherbime ne kete sektor, ullishtat, vreshta dhe pentaria, por edhe tregti dhe biznese te ndryshem.

-Qendra e Bashkise propozojme te jete Paper, si nyje e e spostuar nga qendra Elbasan dhe nyje nderlidhese me bashkite e tjera ne qark deri ne Rrogozhine. Pikepyetje ketu eshte NJA Bradashesh, e cila eshte pjese periferike e qytetit, por ka nje arsyetim ekonomik qe te jete pjese e bashkise se re Paper per te siguruar nje shperndarje pertej periferise se pare te qendres se mallrave dhe sherbimeve.

-Emri Bradashesh.


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
4	Elbasan	11-Lunik 	8801	340.8 km2	15	Lunik (Librazhd)	3441	108.8 km2	Lunik, Preval, Dranovice, Kostenje, Letem, Zgosht dhe Koshorisht.
						Orenjë (Librazhd)	3883	112.5 km2	Orenje, Floq, Gurakuq, Ballgjini, Rinas, Zdrajshverri, Zdrajzhi, Neshte, Funares dhe Mexixe
						Stëblevë (Librazhd)	809	119.5 km2	Stebleve, Zabzun, Llange, Sebisht, Moglice, Prodan, Borove

Shenim:

-Bashkia Lunik, krijohet nga 3 NJA te Bashkisë Librazhd: Luniku-Orenje-Stëblevë. Baza e zhvillimit ekonomik eshte bujqesia, blektorja, sherbimet lokale dhe turizmi potencial. Luniku sic shikohet nga popullsia eshte nje njesi vendore e vogel, por ka specifike siperfaqen e madhe dhe largesin nga qendra.

- Qendra – Lunik, pasi eshte e aksesueshme nga te dy NJA tjera perbere te kesaj bashkie. Shtrihet ne aksin rrugore Librazhd- Diber.

-Emri Lunik. Eshte historic dhe perfaqesuese per krahinën. (permendet emri i qytezës LUBNIK qe nga viti 1467)


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
5	Fier	12-Levan 	45992	216.3 km2	21	Levan	18179	70.9 km2	Levan, Ferras, Peshtan I madh, Peshtan I vogel, Shtyllas, Bishan, Bashkim, Bocove, Martine, Pisha Porro, Qarr
						Frakull	10952	59.1 km2	Frakull e madhe, Frakull e vogel, Ade, Peshtan Bregas, Kafaraj, Kasheshte, Shesh Musalala, Cerven.
						Cakran	16861	86.3 km2	Cakran, Cakran I ri, Floq, Buz Madh, Hambar, Varibop, Vjose, Kreshpan, Gjorgos, Vreshtas, Gorishove, Gjonc

Shenim:

-Bashkia Levan: krijohet nga bashkimi i 3 NJA te bashkise Fier. Levan, Frakull dhe Cakran. 3 NJA shume te forta nga ekonomia bujqesore por jo vetem dhe me nje popullsi shume te qendrushme, me mbi 10.000 banore, dhe ne total mbi 45.000 banore. Baza ekonomike vec bujqesi eshte e lidhur me sherbim dhe prodhime te sektorit bujqesor, sera, perpunime produktesh, sherbime dhe biznese te kategorive te ndryshme etj etj.

-Qendra e bashksie propozohet te jete Levani per arsye te historise se saj si nje qender urbane dhe qyteze, me potencial dhe aftesi akomoduese per qender administrative dhe me konektivitetet te mire per fshatrat e tjera dhe qytetin Fier.

-Emri i Bashkise-Levan pasi eshte me perfaqesues i zonës.


N r	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Fier	13-Dushk 	33834	172.7 km2	21	Dushk i Madh (Lushnjë)	12540	44.2 km2	Gramsh, Dushk Peqin, Konjat, Zham Fshat, Dushk i madh. Zham Sektor, Thanasaj.
						Ballagat (Lushnjë)	3967	24.7 km2	Ballagat, Gjuzej, Garunjas, Gjyshaj, Jazexhi, Manasufaj, Xibrake
						Golem (Lushnjë)	7905	27.1 km2	Golem i madh, Allprenaj, Shegas, Hajdaraj, Plug, Golemi i vogel
						Hysgjokaj (Lushnje)	3717	18.1 km2	Hysgjokaj, Kurtin, Canakaj, Kupaj dhe Lekaj
						Karbunare (Lushnje)	5705	58.6 km2	Karbunare e Siperme, Mollas, Kasharaj, Kashtebardhe, Stan Karbunare, Zgjane, Balaj, Skilaj, Murriz-Peqin dhe Bickaj.

Shenim:

-Bashkia Dushk krijohet nga bashkimi i 5 NJA qe sot i perkasin bashksie Lushnje Edhe kjo bashki me mbi 30.000 banor eshte potenciali ekonomik bujqesore me rendesi ne rajon. Sektori bujqesor sot po kthehet ne prioritet te keto zona, ekonomia rurale dhe jeta e fermerit do kene rritje te ndjeshme. Sherbime, prodhime dhe linja te tjera biznesi bujqesor dhe blektoral, apo linja sherbim dhe biznese te kategorive dhe llojeve te ndryshme perbejn mundesi dhe potencial ekonomik dhe zhvillimi ne kete bashki.

-Qendra e bashkise: propozhet te jete Dushku si me i aksesueshme dhe me mundesi akomoduese per administraten bashkike dhe nje nyje e barazlanguar nga zona me e thelle drejte qendres se bashkise Dushk dhe drejte qytetit Lushnje.

Emri: Dushk pasi është me perfaqesues i zonës.


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Fier	14-Ardenicë 	42259	155.4 km2	21	Kolonjë (Lushnjë)	8352	29.7 km2	Kolonje, Gorre, Bishqethem, Lumth, Rrapes Fshat, Shakuj, Ardenice, Bitaj, Rrapes Sektor.
						Bubullimë (Lushnje)	7144	42.5 km2	Bubullime, Eskaj, Gjonas, Halilaj, Pirre, Kamcishte, Imsht
						Fier-Shegan (Lushnje)	9973	27.4 km2	Jeta e re, Kosove e vogel, Fier Shegan, Kocaj, Barbullinje, Clnar, Sejmenas, Thane, Cukas, Murriz kozare, Qerret I vjeter, Qerret I ri, Bickaj I ri.
						Allkaj (Lushnje)	6460	16.7 km2	Toshkez, Zhekizhan, Delisufaj, Bickaj I vjeter, Allkaj, Lifaj, Cukas I ri, Mazhaj.
						Krutje (Lushnje)	10330	39.1 km2	Krutje e siperme, krutje e poshtme, Fier I ri, Zhyn, Rupaj, Lifaj I vjeter, Kadiaj, Ngrurres I madh, Ndurres I vogel, Arrez, Gjaz

Shenim:

-Bashkia Ardenice krijohet nga bashkimi i 5 NJA të Lushnjes. Kjo bashki konsiderueshem e madhe ne popullësi, është njesi vendore mbi baza ekonomike nga sektori bujqësor, turistik e historik. Ardenica mendojme se do te mari nje zhvillim te madhe si nje fshat turistik qe jeta administrative do ta gjalleroje. Bashkia Ardenice ka dalje ne det.

-Qendra e bashkise propozohet te jete Kolonja /Ardenica. Ardenica eshte per bashkise dhe e aksesueshme me infrastrukure qe lidh dhe nderlidh te gjithe zonen dhe e vendosur prane aksit kryesore te autostrades.

-Emri: Ardenice si me perfaqesuesi per krahinen, me unifikuesi, me me histori dhe domethenie qe nga Manastiri qe mban daten 1282 per gurin e pare te themelit deri me sot.

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Fier		13556	195.02 km2	15	Fratar (Mallakaster)	3221	54 km2	Behaj, Dames, Gadurove, Malas, Kremenar, Ninesh
						Selitë (Mallakaster)	877	13.22 km2	Selite, Gjerbes, Kapaj, Cerrile.
						Greshicë (Mallakaster)	1837	22 km2	Greshice, Greshice e Re
						Hekal (Mallakaster)	4645	54 km2	Hekal, Klos, Mollaj, Rromes.
						Kute (Mallakaster)	2976	51.8 km2	Kute, Drizar, Anebreg, Corrush, Pocem

Shenim:

-Bashkia Fratar krijohet nga bashkimi i 5 NJA ne Bashkine Mallakaster. Eshte nje bashki tejet rurale dhe kodrinore, jo e zhvilluar po me potencial nga sektori bujqesor. NJA jane me nje popullesi te vogel, jo shume te qendrueshme.

-Qendra e Bashkise: Fratar per arsye se edhe zona identifikohet me qendren urbane te Fratarit, eshte si qender biznesi (tregu) per te gjithë ate zone, si dhe ka lehtsire per te akomoduar jeten administrative te bashkise se re. Ka nje nje konektivitet te mire me pjesen me te madhe te fshatrave ne zone.

-Emri: Fratar si me perfaqesuesi dhe historiku i krahines.

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
6	Korçë	16-Voskopojë	7681	276.1 km ²	15	Voskopojë	1508	106.8 km ²	Voskopoje, Shipske, Krushove, Gjonmadh, Lavdar
						Lekas	392	94.8 km ²	Lekas, Marjan, Gjonbabas, Gumnujas, Shkozan, Xerje, Tudas, Gjergjevice, Lavda Brozdovec, Mazreke, Poponive.
						Voskop	5781	74.5 km ²	Voskop, Dersnik, Polen, Vincan, Goskove Lart, Goskove Poshte, Damjanec.



Shënim:

-Bashkia Voskopoje krijohet nga bashkimi i 3 NJA nga Bashkia Korce. Kjo eshte nje bashki me terren kodrinor dhe malor. Ka nje ekonomi kryesisht bujqesore por me nje theks te fort turistik dhe historik qe mbart vlere shume te medha. Konsiderohet nga bashkite e reja si bashki me popullesi te 10.000 banore.

-Qendra e bashkise propozohet te jete Voskopoja. Edhe pse eshte ne anen tjetere te dy NJA referuar afersise me qytetin Korce, vendosja e administrates ketu lidhet me historine e Voskopojes si qender turistike dhe me mundesi per te akomoduar jeten administrative te zones.

-Emri bashkise: Voskopojë, per arsye se ky emer eshte me identifikuesi dhe perfaqesuesi historik dhe aktualisht e zhvilluar si e tille qe nga viti 1330.

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Korçë	17-Leskovik	9911	301.5 km2	15	Leskovik - Qendër Leskovik (Erseke)(kolonje)	2981	217.8 km2	Qyteti Leskovik, Pobicke, Cercke, Radat, Radove, Postenan, Lashove, Peshtan, Pode, Kovacisht, Vrepcke, Germenj, Radanj, Gline, Gjirakar.
						Barmash (?) (Kolonje)	6930	83.7 km2	Barmash, Leshnje, Shales, Gozhdorazhd, Sanjollas, Kamnik, Benjez, Radimisht, Arrez, Rajan




Shenim:

-Bashkia Leskovik krijohet si bashkimi i 3 NJA te bashksie Kolonje sot, si Leskovik Qender, Leskovik dhe Barmash. Nje bashki me popullesi relative, por me nje histori te madhe, qe meriton perqendrim adminisitrativ dhe territorial. Ekonomia eshte nga bujqesi dhe turizmi, sherbimet, bizneset etj. Leskoviku ka qen bashki me vete deri ne 2015, dhe me nje territor me siperfaqe te konsiderueshme.

-Qendra e bashkise: Leskoviku. Ka qene qender dhe bashki deri me 2015, ka mundesi te larta te akomodoje jeten dhe aktivitete administrative.

-Emri: Leskovik, pasi eshte identifikues dhe perfaqesues i tere krahines dhe rikthim i bashkise ekzistuese me te njejtin emer.


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Korçë	18-Drenove 	14998	391.1 km2	15	Mollaj	3438	54.7 km2	Mollaj, Floq, Pulahe, Uje Bardhe, Kamenice
						Vithkuq	1519	243 km2	Vithkuq, Leshnje, Gjanc, Lubonje, Rehove, Roshanj, Trebicke, Grabocke, Stratoberdh, Treske, Panarit, Shtylle, Cernerice
						Drenovë	10041	93.4 km2	Drenove, Mborje, Boboshtice, Morave, Qatrom, Ravonik, Turan, Dardhe

Shenim:

-Bashkia Drenove krijohet nga bashkimi i 3 NJA nga bashkia Korce. Mollaj, Drenove dhe Vidhkuq. Bashkia ka nje potencial te mire te zhvillimit te bujqesise, vreshtari dhe turizmit. (parku drenoves) dhe Tumat ne Mollaj. Por nga ana tjeter, linja sherbimi dhe prodhime nga kompani dhe biznese te ndryshme qe tentojne te shkojne drejt Drenoves dhe Mollaj per tju larguar qendres se Korces, perbejne prespektiven e afert per zhvillim te qendrueshem. Nga popullsia eshte e konsiderueshme me bashkite qe kemi sot nga ndarja me 2014, nderkohe qe Vithkuqi eshte pjesa me malore e kesaj bashkie, po sigurisht me potencialin e saj natyror te kapitalit.

-Qendra e Bashkise-Mollaj- Propozohet qe qendra administrative e bashkise Drenove te jete Mollaj. Arsyetimi ne kete rast lidhet me faktin qe Mollaj eshte nje zona gjeografike perbashkuese per Vithkuqin dhe Drenoven, eshte ne gjendje te akomodoje potencialet administrative te bashkise se re, ka konektivitet te mire dhe lidhje me akset rrugore ne zone dhe drejt qendres se Korces. Edhe ne kete rast krijojme nje nyje administrative dhe ekonomike konkurruese te qytetet dhe plotesuese e saj, si dhe vendosim nje barazlagesi nga qendra e qytetit. Eshte e diskutueshme.

-Emri: Drenovë, emër historik, është perfaqësues për krahinën.


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Korçë	19- Pojan	25716	166.6	21	Pojan (Maliq)	16694	86 km2	Fshatrat; Pojan, Zvezdë, Shëngjergj, Kreshpanj, Plasë, Zëmlak, Burimas, Pendavinj, Terovë, Rov, Orman, Rëmbec
						Bulgarec (Korce)	9022	80.6 Km2	Fshatrat; Bulgarec, Lumalas, Biranj, Melcan, Porodine, Dishnice, Shamoll, Belorta, Kuc i zi, Barc, Ciflig, Malovec, Nevicisht.

Shenim:

-Bashkia Pojan, krijohet nga bashkimi i 2 NJA (Pojan dhe Bulagrec).Pojani krijohet si një bashki fushore. Si e tille kjo bashki perben nje nyje administrative dhe ekonomike. Nga ana e zhvillimit ekonomik eshte bujqesia dhe sektoret e integruar qe derivojne prej saj. Popullesia e Bashkise Pojan me këte kompozim arrin 25.000 banore, cka do te thote se eshte nje bashki konkruuese me bashkite e tjera ne rajon dhe eshte nga bashkite e reja me popullsi te madhe (25.000-35.000), disa here me e madhe se shume bashki sot.

-Qendra: propozohet qe qendra e bashkise Pojan te jete Pojani. Per arsye se eshte me popullsi me te madhe, me potenciale per te akomoduar jeten administrative, sociale, ekonomike dhe politike per tere zonen qe perfaqeson. Ka nje nderlidhje te mire ne cdo aspekt per te gjithë njesite. Konektiviteti dhe mobiliteti konvergjojne me Pojanin.


-Emri: Pojan si më përfaqësuesi dhe përbashkuesi për zonen që do te përfaqesojë.

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsi a	Siperfaq e	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsi a	Siperfaq e	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Korçë	20- Starovë	36007	352.6 km2	21	Bucimas (Pogradec)	19981	58.8 km2	Bucimas, Verdove, Remenj, Geshtenjas, Barcallek, Guras, Peshkepi, Tushemisht
						Cerrave (Pogradec)	9545	89.2 km2	Cerrave, Blace, Bletas, alarup, Pretushe, Grabovice, Nizhavec, Kodras, Leshnice, Lumas, Qershize
						Trebinje (Pogradec)	3026	117.7 km2	Trebinje, Cezme e madhe, Cezme e vogelm Hondisht, Selce e Siperme, Llenge, Plenisht, Hoshtece, Zemce, Potgozha, Maline, Kalivac, Pevelen, Dunice, Guri I bardhe.
						Dardhas (Pogradec)	3455	86.9 km2	Dardhas, Stropcke, Grunj, Prenisht, Derdushe, Osnat, Lekas, Nice, Sterkanj.

Shenim: Bashkia Starove krijohet nga bashkimi i 4 NJA Bucimas, Cerrave, Trebinje dhe Dardhas. Bashkia prazanton si dege te zhvillimit ekonomik, bujqesin, blegtorine, turizem dhe linja sherbimesh e prodhimesh lokale.

-Qendra e Bashkise: Bucimasi per arsye se eshte me e urbanizuar, e aksesueshme dhe prane qendres se qytetit.

-Emri Starove; eshte emri me te cilen identifikohet krahina.


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
7	Kukes	21-Shishtavec	9281	172.7 km2	15	Shishtavec	4689	63.2 km2	Shishtavec, Novoseje, Kollovoz, Shtreze, Borje, Oreshke, Cernaleve.
						Zapod	2637	28.5 km2	Orgjost, Kosharisht, Pakisht, Zapod, Orcikel, Bele, Lojme.
		Topojan				1955	81 km2	Topojan, Xhaferraj, Turaj, Brekije, Nimce	

Shenim:

-Bashkia Shishtavec krijohet nga bashkimi i 3 NJA te Kukesit (Shishtavec, Zapod dhe Topojan). Zona thuhet malore ne pjesen me te madhe te njesive. Eshte nga bashkite me popullsi te 10000 bonore. Potenciali ekonomik bujqesor me prespektive, por turizmi dimeror por ne te gjithe vitin perbejne potencial te mire per nje bashki te tille. Por edhe aspekte te historise se zones dhe Shishtavecin meritojne vemendje dhe perqendrim administrativ. Kjo bashki ka dhe nje pike kufitare me Kosoven, dhe siguron nje njeje mes dy vendeve dhe komuniteteve per nje nderlidhje sociale dhe ekonomike.

-Qendra e bashkise: Shishtavec, per arsye te aksesit dhe krijimit te nje qendre administrative malore ne sherbim te 2 njesive te tjera por dhe konkurrese me bashkite e tjera. Me rendesi dhe historia qe ka mbartur dhe mban e tere krahina Shishtavec, por dhe mundesi me te medhe per te qene nje qender administrative, nje nga fshtrat me turistike te zones.

-Emri: Shishtavec: eshte me perfaqesuesi ne krahine dhe me identifikuesi për banoret.


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Kukes	22-Bicaj 	11181	395.6 km2	15	Bicaj	5631	84.7 km2	Bushat, Bicaj, Osmane, Mholaj, Mustafaj, Nange, Kolesjan, Domaj, Gabrice, Tershan.
						Ujmisht	1797	50.7 km2	Lusen, Zalle, Malqene, Resk, Ujmisht, Skavice, Tejdrine.
						Bushtricë	1486	53.5 km2	Bushtrice, Gjegje, Matranxh, Palushe, Vile, Barruc, Shpat
						Kalis	827	42.8 km2	Geshtenje, Koder-Geshtenje, Kalis, Gurre, Pralisht
						Grykë Cajë	1440	163.9 km2	Fshat, Caje, Buzemadhe, Shkinak

Shenim:

-Bashkia Bicaj krijohet nga bashkimi i 5 NJA te Kukesit (Bicaj-Ujmisht-Bushtrice-Kalis-Gryk Çaje). Kjo bashki eshte teper malore ne te 4 NJA vec Bicaj qe eshte porta “fushore” per te gjithë fshatrat. Potenciali ekonomik jo i shendetshem, por me shume prespektive nga bujqesia, blegtoria dhe turizmi, alpet, kullotat malore, bjeshket, sherbime dhe biznese, etj.


-Qendra e bashkise: Bicaj. Bicaj ka potencial te madh per te qene qender administrative per bashkine e re. Te gjitha rruget e NJA te tjera kalojne ne Bicaj per te shkuar ne qytet. Nga pikmaja ekonomike Bicaj pervecse sa me siper eshte edhe nje mundesi burimore ekonomike per ate zhvillim urban qe ka sot, ne funksion te nje shperndarje me te mire per pjesen tjetere.

-Emri: Bicaj pasi eshte perfaqesues per krahinen.

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
8	Lezhë	23-Bregu i Matët	29346	74.6 km2	21	Shënkoll	17730	32.4 km2	Shenkoll, Rile, Tale 1, Tale 2, Barbulloje, Gryke-Lumi, Gajush, Alk
						Zejmen	9461	42.2 km2	Zejmen, Tresh, Pruell, Berzane, Pllane, Markatomaj, Spiten. *barbelloje e re
		Barbullojë e re (nja kolsh)				3000			

Shenim:

- Bashkia Bregu Mates krijohet nga bashkimi i NJA Shënkoll dhe Zejmen. Eshte nje bashki e konsiderueshme mire nga popullsia. Me potencial te madh bujqesor, turizem, me nje vije bregdetare qe rrit shume prespektiven e pjeses tjeter rurale te zones.
- Qendra e bashkise propozohet Shënkolli. Eshte qender me popullesi te madhe, me potencial urbanizimi dhe me mundesi akomoduese per te qene qender administrative e bashkise se re. Ka infrastrukture te mire per nderlidhjen me fshatrat dhe qytetin Lezhe dhe aksesin ne vijen bregdetare.
- Emri: Bregu i Matet per arsye se eshte me perfaqesuese per te gjithë banoret e dy njesive qe bashkohen dhe me gjere. Opsion tjeter eshte Shënkoll.
***ka nje propozim qe kesaj bashkie ti bashkohet fshati Barbellonje e re qe eshte pjese ne NJA Kolsh. Arsyetimi eshte se keta kane lidhje dhe sherbimet me Shënkollen dhe jo me Kolshin.**


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative përberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Lezhe	24-Orosh 	7074	302 km2	15	Orosh (Mirdite) Reps.	2868	135 km2	“Qyteti” Reps, Kullaxhi, Blinisht, Pshqesh, Mashterkor, Shemri, Gruke-Orosh, Lgjin, Bulshar, Planet, Ndershen, Nenshejt, Koder-Spac, Gurth-Spac, Lajthize.
						Fan (Mirdite)	4206	167 km2	Klos, Shtrungaj, Bisake, Fan, Zall-Xhuxhe, Katundi I ri, Konaj, Shengjin, Petoq, Xhuxhe, Dardhez, Thirre, Sang, Hebe, Domgjon, Gjakez, Munelle.

Shenim:

-Bashkia Orosh (Zemra e Mirdites) krijohet nga bashkimi i 2 NJA ne Mirdite (Orosh, Fan). Eshte mes tyre nje lidhje e forte krahinore me nje ekonomi te dobet si pasoje e terrenit malor, por me potencial dhe vlera te tjera historike, burime ujore dhe bjeshke, dhe kullosat alpine, qe jane prespektive per turizmin malor si baze ekonomike. Kjo bashki renditet te bashkive me popullesi te vogel ne listen e bashkive te reja qe ne propozojme.

-Qendra e bashkise: qendra e bashkise propozohet Reps per arsye historike, por edhe per arsye se dikur ka qen qyteti Reps, dhe mbart nje trashegimi te aftesive dhe kapaciteve akomoduese te jete administrative. Ka nje nderlidhje me pjeset e tjera dhe aksesohet mire me rrugen e Kombit.

Emri Orosh: pasi njihet si berthama e krijimit te Mirdites dhe mbart kete emer dhe vlera qe nga shekulli XV, dhe per rrjedhoje eshte perfaqesues i krahines.


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Lezhë	25-Zadrimë 	34379	310.26 km ²	21	Balldren	11041	91.2 km ²	Balldren, Mali-Kakariq, Qender-Kakariq, Gocaj, Balldren I Ri, Torovice, Malecaj, Koljakaj.
						Dajc	7378	35.2 km ²	Dajc, Gjader, Gramsh, Mabe, Dragush, Koterr, Zojs
						Kallmet	7510	43.06 km ²	Kallmet I Madh, Kallmet I vogel, Rraboshte, Merqi
						Blinisht	5826	38.1 km ²	Blinisht, Troshan, Fishte, Krajne, Piraj, Baqel, Kodhel
						Ungrej	2624	102.7 km ²	Ungrej, Kashnjet, Gjobardhaj, Kalivac, Ras-Bute, Zinaj, Fregen, Kaluer, Sukaxhi

Shënim:

-Bashkia Zadrimë: krijohet nga bashkimi i NJA Balldre, Dajc, Kallmet, Blinisht dhe (Ungrejt dikur krahine mirditore). Perfaqeson nje popullesi mbi 30000 bnaore, ne nje terren dominat fushor, kodrinor dhe pjesa malore qe i perket Ungrejit. Prespektiva ekonomike eshte nga sektori bujqesor, vreshtaria, agroturizmi dhe turizmi me nje rritje dinamike, linja sherbimi dhe prodhime, te sektoreve te ndryshem, biznese te llojeve te ndryshem pasuri natyrore etj etj. Eshte nje rajon etnografik me rendesi te madhe.

-Qendra: bashkia propozohet te kete qendren ne Balldren, per arsye se eshte mire e aksesueshme nga te gjithe njesite perberese, ka infrastrukture qe siguron konektivitet me fshatrat dhe qyetetin Lezhe. Eshte e vendosur ne rrugen lidhese Shkoder-Lezhe, ka kapacitet per te qene qender e administrates se re bashkiake.

-Emri: Balldre pasi eshte me perfaqesuesi dhe identifikuesi i krahines.


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Lezhë	26-Milot	21682	174.6	21	Milot (Kurbin)	12379	112 km2	Milot Qyteti Milot, Fshatrat; Skuraj, Mal Milot, Fush Milot, Mal Bardhë, Mal Bardhe I siperm, Gallatë, Selitë, Gernac, Vinjoll, Shullaz, Prozhmë, Delbnisht, Ferr-Shkopet, Shkopet
						Fushë-Kuqe (Kurbin)	9303	62.6 km2	Fushë-Kuqe Qyteti Laç, Fshatrat; Laç (Sanxhak) Fshatrat; Fushë - Kuqe, Adriatik, Patok, Gorre, Gurëz

Shenim:

-Bashkia Milot krijohet nga bashkimi i 2 NJA Milot dhe Fushkuqe qe sot i perkasin Kurbinit. Bashkia ka nje shtrirje nga liqeni shkopet deri ne Adriaktik. Bashkia prezanton nje simbioze midis zones malore te Milotit dhe zones fushore te Fush-Kuqe, te cilat i bashkon qendra apo qyteti I Milotit. Kjo bashki ka nje ekonomi me prespektive nga sektori agrobujqesor, malor, burimet e ujit, bregdeti dhe turizmi, sherbime, biznese, linja prodhime etj.

-Qendra. Bashkia propozohet me qender ne Milot, per arsye se Miloti eshte nje qytet, ka lidhje te mira lokale dhe rajonale dhe kombetare, ka aftesi akomoduese per jeten dhe aktivitetet adminisitrative. Miloti ka qen qendra e ketyre du njesive kohe me pare.

Emri: Milot per arsye se aty eshte qendra, eshte emri qyetetit, eshte perfaqesues i zones, mbar histori nga principate e Skurrajve ne shukullin 12-15.


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
10	Tirane	27- Farke 	48072	266 km2	21	Petrelë	6899	66.5 km2	Petrelle, Mullet, Stermas, Picall, Shenkoll, Gurre e Madhe, Gurre e Vogel, Daias, Barbas, Fikas, Mangull, Qeha, Shytaj, Hekal, Kryezi, Perellesh, Durishte* (Dumje dhe Vishaj nga Vaqarri)
						Baldushk	5346	85 km2	Baldushk, Mumajes, Fushas, Balshaban, Shpate, Isufmucaj, Mustafakocaj, Kocaj, Kakunj, Vesqi, Parret, Shenkoll, Vrap, Shpat I Siper.
						Bërzhit	5940	77 km2	Ibe, Berzhite, Dobresh, Ibe e Poshtme, Pellumbas, Mihajas-Cirme, Kus, Fravesh, Kllojke, Pashkashesh, Luge-Shalqize, Rozavere
						Krrabë	3023	16.3 km2	Krrabe, Mushqeta, Skutere
						Farke	26864	21.2 km2	Farke, Farke e madhe, Lunder, Mjull Bathore, Sauk, Selite

Shenim:

-Bashkia Farkë krijohet nga bashkimi i NJA Petrelle, Baldushk, Berzhit dhe Krabe, Farke. Bashkia ka një terren gjeografik të kombinuar mes fushes dhe kodrinave. Baza kryesore e ekonomisë është bujqësi, turizmi dhe potenciali i madhë zhvillimor nga ndertime dhe komplekset rezidenciale, hotelite dhe restorantet turistike. Vreshta dhe ulliri zënë një pjesë të madhë në ekonominë e zonës, si dhe agroturizmi dhe turizmi historik. Gjithashtu, tendenca për 'shfryrje' nga presioni urbanizimi dhe ndertimet në qendër të Tiranës, do të çojnë në vendosje të bizneseve apo linjave të prodhimit apo shërbimit në këto zona, dhe kjo do të ndikojë pozitivisht në ekonominë dhe mirëqenien e bashkisë Petrelle dhe tërësive të saj.


-Qendra bashki propozojmë të ketë qendrën në Farke për arsye konkretive me zonën, për arsye të urbanizimit, për arsye traditë dhe historie që këto zona dikur ishin në lokalitetin me emrin Petrel, por edhe me potenciale të mëdha akomoduese për jetën dhe aktivitetet administrative. Petrelle vetë është një ndër fshatrat turistike me dy kështjela që janë mjaft identifikues edhe sipërfaqes në travat e saj. Ka një konektivitet perfekt me autostradën e Elbasanit.

-Emri Farkë..?

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Tiranë	28- Kashar 	87923	239 km2	31	Ndroq	9590	71 km2	Ndroq, Zbarqe, Kercukje, Zhurje, Lagje e re, Pinet, Sauqet, Calaberzeze, Shesh, Grebllesh, Menik
						Vaqarr	10686	45 km2	Vaqarr, Algjate, Arbane, Bultice, Damjan-Fortuzaj, Gropaj, Lalm, Prush, Vishaj, Sharre. *Fshati Dumje dhe Vishaj- shkojn me Petrelen
						Pezë	6394	87 km2	Peze e Madhe, Peze Helmes, Peze e Vogel, Varosh, Maknor, Dorez, Gror, Grece, Pajane, Gjysylkane.
						Kashar	61253	36 km2	Kashar, Yzberisht, Mezez, Yrshek, Katund I ri, Kus dhe Mazrek, Kashar Koder, Mezez Fushe, Yzberish 1

Shënim:

- Bashkia Kashar krijohet nga bashkimi i NJA Ndroqe, Vaqar, Peze dhe Kashar. Eshte nje bashkia fushore dhe kodrinore, me prespektive te mire ne sektorin bujqesore dhe turistike te brendeshem. Bashkia ka nje pupullsi te konsiderushme. Baza e zhvillimit ekonomik eshte e ldhur edhe me linja sherbim dhe prodhime apo magazinime te produkteve te ndrsyhme, sherbime apo biznese te ndryshme.
- Qendra e bashkise: Kashari per arsyese te qasjen ndaj urbanizimit, te historise se saj, per aftesi akomodues per aktivitet administrative. Propozohet qendra ne Kashar me iden per te krijuar dhe ne kete rast nje nyje admsitrative ndermejt Tiranes dhe Durrresit, dhe per ti dhe nje dinamik te re zhvillimire, dhe konkurues zones dhe aksit rrugore Ndroq Dures perkundrejt aksit te ausotstrades Tirane-Durres.
- Emri:Kashar.

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Tiranë		50630	252.52 km2	21	Dajt	29343	114.5 km2	Brrar, Ferraj, Tufan, Tufine, Linze, Lanabregas, Surrel, Priske e madhe, Shkalle, Qafemolle, Selbe, Darshen dhe Murth
						Shengjergj	3498	29.62 km2	Shengjergj, Verri, Ure, Burimas, Shengjin, Facesh, Bize, Fage, Parpuje, Vakumone, Domje, Derje.
						Zall-Bastar	5120	52.5 km2	Zall-Bastar, Bastar I mesem, Bastar Murriz, Vilez, Zall Mner, Mner I siperm, Bulcesh, Zall Dajt, Besh, Dajt, Shengjin I vogel, Selite Mal
						Zall-Herr	12669	55.9 km2	Zall Herr, Dritas, Cerkeze-Morine, Qiham, Kallmet, Herraj, Pinar, Priske e vogel, Radhesh


Shënim:

-Bashkia Dajt krijohet nga bashkimi i 4 NJA:Dajti-Shengjergj-Zall Bastard he Zall Herr. Per nga popullsia kjo bashki konsiderohet me popullsi mbi mesateren e bashkive qe kemi sot.Baza ekonomimike e kesaj eshte perbere nga dy drejtime kryesore: zhvillimi rural (bujqesia dhe blektori) ne zonat malore si Shengjergj dhe Zall Bastar dhe pjeserisht Zall Herr, dhe sherbimet nga zona urbane e Dajtit, si dhe turizmi, hoteleriae etj.

-Qendra e bashkisë: Dajti

-Emri i Bashkise: Dajti, unifikues, perfaqesues dhe identifikues.

Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
11	Vlorë	30-Kotë	13979	385.5 km2	15	Kotë (Selenice)	6461	131 km2	Kote, Gumenice, Hysoverdhe, Lapardha, Mavrove, Mazhar, Vajze, Vodice, Shkalle Mavrove, Drashovice
						Brataj (Selenice)	4609	156 km2	Brataj, Lepenice, Gjorm, Velce, Ramice, Mesaplik, Matogjin, Bashaj, Vermik, Malas.
						Sevaster (Selenice)	2909	98.5 km2	Sevaster, Golimbaz, Dushkarak, Shkoze, Mazhar, Ploce, Lezhan, Amonice.




Shënim:

-Bashkia Kotë, krijohet nga bashkimi i 3 NJA te bashkisë Selenice sot, Kote, Brataj dhe Sevaster. Kjo bashki është emiksuar me trene fushor, kodrinor dhe malore, me një ekonomi relativisht të shëndetshme, por me potenciale nga sektori bujqësor dhe turizmi shërbimet vendore, boneset e vogla, pyje dhe kullotat malore, sidomos tani me rrugën e lumit, përbejn një prespektive të afert zhvillimi.

-Qendra: Kotë- Te tre këto njësi dhe fshatrat e tyre i bashkon Kote si qender me urbane, e vendosur në aksin e rrugës së lumit, e aksesueshme mirë me pjesën tjetër të zonës, është një njësi administrative dhe ekonomike mes Selenice dhe Vlores deri në Himarë. Ka kapacitet akomodues për jetën dhe aktivitetet administrative.

-Emri: Kotë/Amantia është identifikuar për tërë krahinën.


Nr	Njesi te qeverisjes vendore		Popullsia	Siperfaqe	Nr. i Keshilltareve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Vlore	31- Novosele	31983	188.5 km2	21	Novosele (Vlorë)	17479 +4720	137 km2	Novosele, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dellenje, Delisuf, Trevllazer, Cerkovine, Skrofotine, Fitore, Akemi. *panaja-oshetim-kerkove-basrove:(ikin nga NjA Qender) 4720 banore
						Shushice (Vlorë)	9784	51.5 km2	Shushice, Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithash, Mekat, Llakatund, Ceprat, Risili

Shenim:

-Bashkia Novosel perbehet nga 2 NJA- Novosel dhe Shushice qe sot jan me Vloren, ndersa para 2015 kan qene komuna. Ekonomia ne Novosel bazohet ne bujqesi, blegtori, punimin e ullishteve, vreshtari, peshkim dhe ne llojet e ndryshme te bizneseve(duhen permendur fabrikat e vajit, kantinat e veres, miniera e kripes qe eshte 1500 hektar, punishte e perpunimit te bretkosave dhe gjallesave te detit). Eshte marre parasysh dhe sektori i turizmit, ku jane planifikuar 3 resorte turistike pergjate vijes bregdetare. Kete sektor e favorizon dhe ndertimi i aeroportit ne Akerni. Pershkohet nga nje vije bregdetare (plazhi i Hidrovorit) 13 km te gjate ne vije ajrore. Ka dy dalje ne det. Vija bregdetare fillon nga grykederdhja e Vjoses dhe perfundon ne Dalan.

-Qendra- Novoselë pasi njësi administrative klasifikohet në njësitë me rrjet rrugor të gjërë dhe me gjendje teknike relativisht të kënaqshme kryesisht në anën perëndimore. Të gjithë fshatrat e njësisë lidhen me qendrën e njësisë me rrugë automobilistike të asfaltuara. Baza e zhvillimit ekonomik eshte sektori bujqesore, dhe agroturizme, sherbimet, linja prodhimi bujqesore dhe industrial, biznese te llojve dhe kategorive te ndryshme. Novosela ka aftesi per te organizuar dhe akomoduar jeten administrative, si qender me urbane, dhe nderlidhje te mire me pjesen tjeter te zones.

-Emri: Novosele per vete historin qe mbart kjo qender, eshte identifikuese dhe per pjesen tjeter te krahines.


Nr	Qarku Njesi te qeverisjes vendore		Popullsi a	Siperfaq e	Nr. i Keshilltarev e	Njesite administrat ive perberese	Popullsia	Siperfaqe	Fshatrat ne perberje te tyre
	Vlore	Bashkia							
		32-Orikumi 	12029	313 km2	15	Orikum	12029	313 km2	Qyteti Orikum, Fshatrat; Dukat, Dukat Fshat, Tragjas, Radhimë

Shënim:

-Bashkia Orikum, eshte e vetmja bashki ne listen e propozuar qe rikthehet ne kushte e njesise vendore sic ka qene deri ne 2015.Sot eshte NJA e Bashkise Vlore. Komuniteti i Bashkisë Orikum, është një komunitet me zakone e tradita etnokulutore, historike e gjuhësore të përbashkëta , të cilat janë në mardhënie aktive si pjesë e krahinës së Labërisë.Baza e zhvillimit ekonomik e perben bujqesie, ullishte, pemtari,vreshtari, etj biznes ea po sherbime ne kete sektor.Por ka nje tendecë në rritje ka sidomos në zonën bregdetare për rritjen e bizneseve të shërbimit në fushën e hotelerisë dhe restoranteve , për tju përgjigjur kërkesve në rritje të numrit të turistëve per te viziatuar **Monumente Kulturore dhe historike** Parku Arkeologjik i Orikut,Kisha e Marmiroit,Ujësiëllësi I Ferrunit,Kalaja e Gjon Bocarit,Dervish Aliut,Kalaja e Sofës , Shpella e Kavasallit ,Shkolla e Kuqe, Mbihipja e Çikës,Parku Kombetar i Llogaras,Tragjasi I Vjetër ,Pisha Flamur, Shpella e Haxhi Alisë etj. **Monumente Natyrore:** Rrepet e Izvorit, Rrapi i Burrave Tragjas, Shpella e Shkruar, Gjiri dhe Shpellat e Grames, Mbihipja Aktive e Dukatit, Shkëputje e Re Aktive e Llogarasë, Shpella e Duk Gjonit, Tarraca Detare, Rrapi i Dukatit, Rrapi Tragjasit të Vjetër etj.

Qendra: Orikum, sic ka qene gjithemon deri para viteve 2015

Emri- Orikum, Emri historik i bashkisë.

Nr	Njësi të qeverisjes vendore		Popullsia	Sipërfaqja	Nr. i Këshilltarëve	Njesite administrative perberese	Popullsia	Sipërfaqja	Fshatrat ne perberje te tyre
	Qarku	Bashkia							
	Vlore	33-Ksamil 	7716	63.6km2	15	Ksamili	7716	63.6km2	Ksamil,Manastir, dhe Qyteti Antic Butrinti.

Shenim:

-**Bashkia Ksamil** është tërësisht **komunë** Ksamil sic ka qen deri ne vitin 2015 në jug të **Shqipërisë**. Komuna Ksamil ka një sipërfaqe prej 63.6 km2, popullsi prej 7716 banore dhe përfshin në territorin e saj qytezën e Ksamilit dhe fshatin Manastir, por nga ana tjetër ndodhet qyteti antik i **Butrintit**, liqeni i Butrintit si dhe ishujt e saj.

-Qendra ne Ksamil.Ksamil përbën një nga pasuritë si natyrore edhe arkeologjike më të pasura në vendin tonë. Ajo përbën një nga perlat e natyrës shqiptare, me plazhe të pastër e të virgjër, me vijë bregdetare të larmishme me gjire,klimë të butë, kepa,ishuj e shkembinj interesantë me monumente kulture, me Butrintin dhe Sarandën afër, fare pranë ishullit të **Korfuzit** dhe rrugës detare nga **Greqianë Itali**, pra një pikë e rëndësishme për nje turizëm elitare. Bashkia Ksamil ndodhet në krahinën jugore të vendit në një largësi prej 12 km larg qendrës.Te gjitha keto pasuti natyrore dhe historike perbejne bazen ekonomike te kesa bashkie.

-Emri: Ksamil.

